REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. 508/ Prot. Tiranë, më 22/10/ 2026

Lënda: Kërkesë për marrjen e masës disiplinore.

Drejtuar: **Z. NIKO PELESHI**

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

SEKRETARIATIT PËR PROCEDURAT, VOTIMET DHE ETIKËN

Baza Ligjore: *Neni 63 dhe neni 65/1 pika1 dhe 7, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;*
Neni 6 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën,

Në seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë të datës 22 tetor 2026, që në fillim të seancës plenare u regjistruan incidente të rënda, të shoqëruara me fyerje, provokime dhe sulme fizike nga deputetë të opozitës, duke cënuar rëndë rendin dhe zhvillimin normal të seancës plenare.

Siç duket edhe nga pamjet dhe videot bashkangjitur kësaj kërkese, por edhe nga publikimet në media, sapo po lexohej Rendi i Ditës nga drejtuesi i seancës deputeti Flamur Noka i është drejtuar foltores, duke goditur mbi të, dëmtuar mikrofonin e foltores dhe më pas i'u drejtua me fjalë fyese Kryetarit të Kuvendit. Në vijim këto veprimeve të rënda të kryera nga deputeti Flamur Noka, u mbështetën edhe nga deputetë të tjerë anëtarë të grupeve parlamentare të opozitës.

Në momentin që filloi votimi i kalendarit dhe programit të Kuvendit, deputeti Belind Këlliçi mbajti qëndrimin kundër në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, në kushtet që kishte bllokuar foltoren në bashkëpunim me deputetë të tjerë të opozitës. Sipas procedurës Kryetari i Kuvendit i dha fjalën Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste zotit Taulant Balla. Në këtë moment deputeti Belind Këlliçi, jo vetëm që nuk liroi foltoren por shkuli pajisjet e foltores dhe me to vijoi të godiste foltoren. Sapo zoti Balla filloi të fliste deputeti Flamur Noka ka sulmuar fizikisht deputetët socialistë në rreshtat e parë ku ulen duke u marrë kartat e votimit dhe duke dëmtuar pajisjet elektronike, për t'i nxjerrë ato jashtë përdorimit. Gjithashtu deputetët Belind Këlliçi, Besart Xhaferri, Edi Paloka, Fidel Kreka, Luçiano Boçi, fyen dhe goditën me shishe uji deputetët e Partisë Socialiste. Siç vërehet nga pamjet filmike deputetët Ervin Hoxha, Arkend Balla, Fadil Nasufi, Agron Malaj, Bujar Rexha etj janë sulmuar dhe fyer nga këta deputetë gjatë procesit të votimit. Gjithashtu deputetët , Gjin Gjoni, Bardh Spahia, Albana Vokshi, Elda Hoti, Xhelal Mziu, Gent Strazimiri, Enno Bozdo, Kastriot Piroli, Kliti Hoti, Flamur Hoxha, Arjan Ndoja, Ivi Kaso, Zija Ismaili, Blendi Himçi kanë marrë pjesë në bllokimin e foltores duke penguar zhvillimin e rregullt të seancës plenare.

Sjellja e këtyre deputetëve përbën shkelje të rënda të normave të etikës dhe disiplinës parlamentare, duke cenuar autoritetin e Kuvendit dhe kushtet për ushtrimin e rregullt të veprimtarisë parlamentare.

Veprimet e deputetëve të sipërcituar u shoqëruan me bllokim të foltores së Kuvendit, tensione dhe zhurmë të vazhdueshme nga deputetë të tjerë të opozitës, duke penguar zhvillimin e rregullt të procedurës së votimit.

Për sa më sipër, *bazuar në nenin 63, dhe nenin 65/1, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të ndryshuar dhe nenit 6 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,* paraqesim kërkesën si më poshtë:

1. Marrjen e masës disiplinore "Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare" për 60 ditë referuar nenit 65/1, pika 7 për deputetin Flamur Noka, për veprimet e sipërpërmendura.
2. Marrjen e masës disiplinore "Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare" për 60 ditë referuar nenit 65/1, pika 7 për deputetin Belind Këlliçi, për veprimet e sipërpërmendura.

3. Marrjen e masës disiplinore "Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare" për 60 ditë referuar nenit 65/1, pika 7 për deputetin Fidel Kreka, për veprimet e sipërpërmendura.
4. Marrjen e masës disiplinore "Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare" për 60 ditë referuar nenit 65/1, pika 7 për deputetin Edi Paloka, për veprimet e sipërpërmendura.
5. Marrjen e masës disiplinore "Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare" për 60 ditë referuar nenit 65/1, pika 7 për deputetin Besart Xhaferri, për veprimet e sipërpërmendura.
6. Marrjen e masës disiplinore "Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare" për 60 ditë referuar nenit 65/1, pika 7 për deputetin Luçiano Boçi, për veprimet e sipërpërmendura.
7. Marrjen e masës disiplinore "Përjashtim nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare" për 10 ditë referuar nenit 65/1, pika 1 për deputetët Gjin Gjoni, Bardh Spahia, Albana Vokshi, Elda Hoti, Xhelal Mziu, Gent Strazimiri, Enno Bozdo , Kastriot Piroli, Kliti Hoti, Flamur Hoxha, Arjan Ndoja, Ivi Kaso, Zija Ismaili, Blendi Himçi.

DEPUTETËT :

1. RAMION KURTI
2. SARA MILA
3. Pino Shilumer
4. Adi Dose
5. BESA SPAHO
6. Klevis Joka
7. Kidwina Zaka
8. Elton Ramechi
9. BORA MUZHAQI
10. Jalama Bejly Khoshe
11. Alma Selami
12. Enriketa Joko
13. ERION MALAJ
14. Erjo Mil